



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

PROJEKT - V E N D I M

Nr. ____ Datë 27/05/2021

“Për shtim fondi për blerje dru zjarri për nevojat e shkollave, kopshteve dhe çerdheve të Bashkisë Dibër ”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.160 datë 30.12.2021, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.32/1 prot. datë 14.01.2021:

Kërkojmë:

- I. Miratimin për shtimin e fondit të planifikuar në buxhetin e bashkisë për blerje “Dru zjarri” me llogari ekonomike “6020200” e cila ka qenë e miratuar në vlerën 7,000,000 (shtatëmilion) lekë dhe kërkon një shtim fondi Drejtoria e Shërbimeve në vlerën 5,000,000 lekë.
- II. Pakësohet fondi rezervë **1810** në vlerën 5,000,000 (pesëmilion) lekë dhe shtohet struktura “**6260**” llogaria **602** në vlerën 5,000,000 (pesëmilion) lekë.
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjësi Financës

Mensur SHEHI

Drejtor Ekonomik

Lorenc CIBAKU

P/Sektorit Juridik

Eloza LUSHA

KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË

Shkëlqim MURRJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR. 37 Date 05.08.2021

“Për shtim fondi për blerje dru zjarri për nevojat e shkollave, kopshteve dhe çerdheve të Bashkisë Dibër ”


Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.160 datë 30.12.2021, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.32/1 prot. datë 14.01.2021: Keshilli ne mbledhjen e dates 05.08.2021 vendosi me 16 vota pro 0 vota kunder 0 vota apstenim:

VENDOSËN:

1. Miratimin për shtimin e fondit të planifikuar në buxhetin e bashkisë për blerje “Dru zjarri” me llogari ekonomike “6020200” e cila ka qenë e miratuar në vlerën 7,000,000 (shtatëmilion) lekë dhe kërkon një shtim fondi Drejtoria e Shërbimeve në vlerën 5,000,000 lekë.
2. Pakësohet fondi rezervë **1810** në vlerën 5,000,000 (pesëmilion) lekë dhe shtohet struktura “**6260**” llogaria **602** në vlerën 5,000,000 (pesëmilion) lekë.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Keshilli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.768/1.prot.

Peshkopi, më 18.08.2021

Lënda : Per vendimin nr. 37, datë 05.08.2021 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.37, date 05.08.2021 “Për shtim fondi për blerje dru zjarri për nevojat e shkollave, kopshteve dhe çerdhëve të Bashkisë Dibër”, konstatova se akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi ka të bëjë me ndryshime buxhetore të cilat duhet të ishin shoqëruar me pasqyrat financiare përkatëse sipas formatit të përcaktuar nga ligji, pavarësisht faktit se vullneti i organit vendimmarrës shprehet qartë për pakësim dhe shtim në zërat e buxhetit sipas parashikimeve ligjore.

Nisur sa sipër, Prefekti në zbatim të bazes juridike të vendosur në pjesën hyrëse të kësaj shkrese, miraton në parim vendimin nr.37, datë 05.08.2021, në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e finances dhe respektimit të disiplinës financiare në fushën buxhetore që për raste të tilla kurdoherë është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e organit ekzekutiv nëpërmjet strukturave të saj përgjegjëse.

